



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar me: Primitje: 24.01.2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01	5009	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Raport nga mbledhja e dytë publike e thirrur nga kryetari i komunës për vitin 2023

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton raport nga mbledhja e dytë publike e thirrur nga kryetari i komunës për periudhën janar-dhjetor 2023 i cili është mbajtur me datën 26.12.2023, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitave të Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna.

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/12/66782.pdf>

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1.Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	83
2. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	83

Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë **83** pjesëmarrës, prej tyre **17** femra dhe **66** meshkuj.





Takimi i cili është mbajtur **26.12.2023** duke filluar në ora **11:00** në sallën e Kuvendit Komunal ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e komunës njoftojnë për aktivitetet komunale, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhes për të cilën është thirrur takimi konkretisht për vitin 2023, ndërsa të pranishmit mund të bëjnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoj kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti ka filluar mbledhjen publike me qytetarë, të cilët i ka njoftuar për punët e realizuara, sfidat dhe të arriturat e komunës përgjatë këtij viti 2023. Ai është shprehur i kënaqur me realizimin e të hyrave vetanake gjatë këtij viti si dhe me investimet e realizuara gjatë kësaj periudhe, investime këto të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Po ashtu kryetari Imri Ahmeti e ka quajtur vitin 2023 si të suksesshëm, duke ja atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit.

Kryetari Imri Ahmeti para të pranishmëve tha se Viti që po e lëmë pas rënditet si ndër vitet më të suksesshme, treguesit dhe indikatorët flasin për rezultate pozitive dhe ky sukses është i gjithë qytetarëve lipjanas, sepse ne kemi vetëm përgjegjësinë e menaxhimit dhe përkushtimi ynë është që ky menaxhim të jetë sa më efikas dhe më cilësor.

Kryetari Ahmeti gjatë takimit me qytetarë, tha se parashikuar në përgjithësi realizimin e buxhetit edhe pse kanë mbetur edhe pak ditë ne përsëri dalim si komunë e suksesshme sepse rreth 95% është në total realizimi i buxhetit e ajo që është më e rëndësishme investimet kapitale ose projektet në teren kalojnë rreth 80%.

Ai po ashtu ka theksuar se edhe këtë vit e hyra vetanake në komunën tonë shënon progres të jashtëzakonshëm duke tejkaluar planifikimin buxhetor, ku deri në këtë pjesë të muajit dhjetor e hyra vetanake ka kaluar planifikimin”, ka thënë Kryetari Imri Ahmeti, duke shtuar se nga 2,337,990.00 është realizuar në 3,342,392.28 .

Në raport me vitin 2022, shihet që në vitin 2023 progresi në realizimin e të hyrave është për 34.49% më shumë, pa i llogaritur donacionet” tha në mes tjerash Kryetari Ahmeti.

Kryetari Ahmeti duke vazhduar takimin me qytetarët lipjanas tha që viti që po lëmë pas Komuna e Lipjanit është renditur ndër komunat me performancë të mirë në vlerësimet dhe matjet e bëra nga organizata e institucione vendore e ndërkombëtare.

Vlenë të theksohet Granti i Përformances nga projekti Demos dhe organizata e institucioneve tjera, vlerësimi nga organizata GAP për transparencë buxhetore ku Lipjani është renditur i pari, ose KDI dhe organizatat tjera për transparencë e llogaridhënie.

Kryetari Imri Ahmeti, para qytetarëve lipjanas ka veçuar disa nga projektet madhore që shënojnë vitin 2023 si: Palestra Sportive, Çerdhet në Shalë dhe Rufc, Shkolla fillore në Ribar të Madh, ndaria e 172 bursave për student

Salla sportive në Banullë e Gillogovc, ndarja e 10 banesave për familjet në nevoje, fillimi i punimeve në Parkingun Nëntokësorë dhe QKMF së bashku me Urgjencën e shumë projekte të tjera siq janë asfaltimi i mbi 32 km rrugë e rrugica, mbi 6 km trotuarë dhe rreth 8 km ndriçim public, renovimi i sallave të sporteve në Gillogovc në Bnaullë, fusha e hapur sportive në Rubovc, salla e sportve në Lipjan dhe shumë projekte të tjera.

Kryetari Imri Ahmeti në fund të këtij takimi ka uruar të gjithë qytetarëve festat e fund vitit, si dhe i ka ftuar që të vazhdojnë të jenë bashkëpunues në zhvillimin e qytetit dhe vendbanimeve tona, sipas kryetarit Ahmeti, pa aktivizimin e gjithë qytetarëve dhe pa bashkëpunimin e koordinimin e frytshëm nuk mund të kemi suksese, duke thënë se unë këtu po e përmbylli prezantimin tim duke ju falenderuar juve për prezencën e juaj dhe për të ju dhënë juve mundësinë për të ngritur ju tema e çështje për të cilat keni interesim.

Kontributi juaj është i jashtëzakonisht i duhur për lokalitetet dhe vendbanimet që ju vini në mënyrë që t'i zgjedhim bashkarisht problemet e ndryshme kolektive.

Ndërsa qytetarët u inkuadruan për të bërë pyetje dhe për të kërkuar sqarime nga Kryetari Imri Ahmeti për shumë çështje.

Takimi ka përfundur në ora 12:15

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	Ka pyetur se a ka në komunën e Lipjanit zyre të punësimit dhe si duhet të punësohet një qytetar në Lipjan. Po ashtu kam edhe disa shetësime tjera e para ka të bëjë me	Hysri Ibrahimi, banor nga fshati Banullë	Kryetari Imri Ahmeti, tha se zyra e punësimit është në Lipjan por është në kuadër të ministrisë, ndërsa për punësimet në administratë sistemi i pranimit të punëtorëve është online dhe ne nuk e menaxhojmë.	Pjesërisht: Zyra e punësimit është në Lipjan por është në kuadër të ministries, ndërsa për administratë është sistemi online

	qentë endacak dhe lypsaret.		Ndërsa për qenët endacak është një shqetësim në gjithë vendin tonë, ne gjatë muajit dhjetor kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me komunat e regjionit të Prishtinës, ku në kuadër të kësaj marrëveshje përfshihet edhe zgjidhja e problemit me qenët endacak ne kemi ndërmarrë disa veprime edhe gjatë vitit 2023 për trajtimin e tyre por është një problem trajtimi i gjithë atyre që vijnë edhe prej komunave të tjera.	
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	Falenderoi kryetarin për investimet të cilat po bëhen në Janjeve por ai tha se kam një vërejtje reth investimeve të cilat po bëhen duhet të kenë një mbikëqyrje me të madhe dhe të njoftohet edhe këshilli i fshatit për investimet të cilat behen nëpër lokalitete në mënyrë që të mbikqyren edhe nga këshillat e fshatrave.	Behxhet Konxheli, qytetarë nga Janjeva	Kryetari Imri Ahmeti: ka potencuar se zakonisht kryetarët e fshatrave kontaktohen kur fillonjnë projektet me qëllim të mbikqyrjes së punimeve, sigurisht që do të duhej që qdo gytetarë me e përcjell punën në teren pasi që projektet po bëhen për të miren e tyre.	Plotësisht: Kryetarët e fshatrave kontaktohen rregullisht kur fillonjnë projektet me qëllim të mbikqyrjes së punimeve, në teren pasi që projektet po bëhen për të miren e tyre.
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	Pos falenderimeve për punët e mira që po bëhen në fshatin Akllap kam një kërkesë të bëhet ndërtimi i një ure në	Muhaerrem Gashi qytetarë nga fshati Akllap	Kryetari Imri Ahmeti: ka thënë se në projeksionet buxhetore janë paraparë të ndërtohen disa ura në venbanimet e ndryshme	Plotësisht: Në buxhetin e komunës për vitet në vazhdim janë paraparë të ndërtohen disa ura

	fshat pasi që aty kalon një person i verbër edhe po është i rrezikshëm kalimi i lumit nga personi në fjalë dhe një ure do të ndihmonte shumë në qarkullimin e banorëve të fshatit.		aty ku ka nevojë më shumë edhe këtë kërkesë të juajen e shohim nëse nuk është e përfshirë në projeksionet buxhetore do ta fusim gjatë vitit.	në venbanimet e ndryshme aty ku ka nevojë më shumë edhe këtë kërkesë të juajen e shohim nëse nuk është e përfshirë në projeksionet buxhetore do ta fusim gjatë vitit.
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	Ka paraqitur një ankesë duke thënë se gjatë rregullimit të kanalizimit me është dëmtuar prona ime private dhe kërkoi nga ana juaj që të më bëhet një zgjidhje për pronen time pasi që me është dëmtuar shumë.	Mehdi Shala, qytetarë nga fshatin shalë	Kryetari Imri Ahmeti: ka theksuar se të gjithë atyre që ju dëmtohen pronat apo edhe pronat publike gjatë punimeve të njoftoni komunën në mënyrë që të merret më shumë përgjegjësit nga kompanitë që i kryejnë punimet.	Plotëisht: Për pronat e dëmtuara publike dhe ato private gjatë punimeve njoftoni komunën në mënyrë që të merret më shumë përgjegjësit nga kompanitë që i kryejnë punimet.
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	Ka falënderuar kryetarin e komunes për projektet të cilat janë zhvilluar në fshatin Shalë e sidomos për ndërtimin e qerdhes ku e kanë mirëpritur shumë këtë projekt banorët e fshatit Shalë, ajo u shpreh mirënjohëse edhe për projektet e tjera të cilat po vazhdojnë.	Xhyla Karpuzi, nga fshati Shalë	Kryetari Imri Ahmeti: tha se edhe gjatë viteve në vazhdim banorët e Shalës do të ju gëzohen edhe shumë projekteve të tjera që t'i realizojmë atje.	Plotëisht: Do të realizohen edhe shumë projekte në Shalë
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	Është shprehur mirënjohës ndaj komunës kryetarit Ahmeti për	Skender Bikliqi, nga Janjeva	Kryetari Imri Ahmeti: ka theksuar se gjatë muajit dhjetor ka nënshkruar	Pjesërisht: Së shpejti do të ketë një linjë funksionale të

	renovimin e QMF-së, në Janjevë por edhe në ralizimin e projekteve të tjera, por ka paraqitur edhe disa kërkesa tjera për ndriçim publik dhe trotuar nga fillim i fshatit - restorant Anija e deri në pjesën e brendshme të fshatit, por edhe një zgjidhje për transportin e udhëtarëve e që janjeva ka shumë nevojë.		marrëveshjen e bashkëpunimit me komunitet e regjionit të Prishtinës, ku në kuadër të marrëveshje përfshihet edhe krijimin e një linje funksionale të transportit urban në relacionin Prishtinë-Lipjan-Janjevë e që pritët shumë shpejtë të funksionalizohet, ai gjithashtu tha se ne vazhdim të angazhimeve tona do të mundohemi t'i realizojmë tjera për banorët e Janjevës.	transportit urban në relacionin Prishtinë-Lipjan-Janjevë.
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023		Mustafa Rexhepi, Gadime e Epërme	Kryetari Imri Ahmeti: tha se me fillim të vitit 2024 do të ndërmarrim veprime të caktuara do e paraqesim kërkesën përmes Kuvendit për pgaesen e angazhimit të kryetarëve të këshillave lokal.	Plotësisht: me fillim të vitit 2024 do të ndërmarrim veprime të caktuara do e paraqesim kërkesën përmes Kuvendit për pgaesen e angazhimit të kryetarëve të këshillave lokal.
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	ka paraqitur si kërkes transportin publik në Janjevë.	Alush Bikliqi, nga Janjeva	Kryetari Imri Ahmeti: Në bazë të marrëveshjes me komunitet e regjionit të Prishtinës, së shpejti do të ketë një linje funksionale të transportit urban në relacionin Prishtinë-Lipjan-Janjevë.	Plotësisht: Së shpejti do të ketë një linje funksionale të transportit urban në relacionin Prishtinë-Lipjan-Janjevë.
Tubimi i dytë publik i kryetarit për vitin 2023	ka shprehur shqetësimin e tij se rruga Skenderbeu nuk mirëmbahet si	Hamdi Rrustemi, nga Lipjani	Kryetari Imri Ahmeti: tha se aty ku nuk shkojnë punët si duhet ne i shkëpusim kontratat	Pjesërisht: Pastrimi rruges Skenderbeu nuk është bërë për

	duhet dhe ka pyetur për punët lidhur për rruge te parkingu i komunes kur pritet të rregullohet.		dhe nuk lejojmë që punët të kryhen shkel e shko. Pastrimi rruges Skenderbeu nuk është bërë për shkak se nuk po ka mundësi ta mirëmbaj kompania pasi që ka shumë vetura të parkuara aty dhe po paraqitet pengesë, por do të ndërmarrim veprime konkrete edhe në atë pjesë.	shkak se nuk po ka mundësi ta mirëmbaj kompania pasi që ka shumë vetura të parkuara aty dhe po paraqitet pengesë, por do të ndërmarrim veprime konkrete edhe në atë pjesë.
--	---	--	---	--

Shtojcë: lista e pjesëmarrësve

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun dhe përgjegjëse për konsultime publike


Bukurie Zejnullahu Jashari

Lipjan, 23.12.2023

**REGJISTRI I PREZENCËS SË QYTETARËVE TË KOMUNËS SË
LIPJANIT, NË DËGJIMIN PUBLIK TË MBAJTUR ME 26.12.2023
NË SALLËN E KUVENDIT ME FILLIM NË ORA 11,⁰⁰**

Nr. Ren.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Fatmir Belushi - Poturoc	Poturoc	Belushi
2	Arush Bitoligi	Tonjeva	Bitoligi
3	Bashir Zekaj	Bashir M.	Zekaj
4	Milozin Shala	Klecko	Shala
5	Mahmut Gashi	ALLAP	Gashi
6	FADIL ALI	GADILIE, ULËT	Ali
7	Skender Gashi	DOBRIQ E KADRI	Gashi
8	Mehdi Avdyli	BREGI ZI	Avdyli
9	Hysri Ibrahim	Banulle	Hysri
10	Qamruddin Krasniqi	Smallov	Krasniqi
11	Rauf Sadiku	Banulle	Sadiku
12	Seni Gashi	Lipjan Allp	Gashi
13	Agim Tasholli	Gadime Ulle	Tasholli
14	AFRIM MENA	BREGI ZI	Menaj
15	Mari Duci	Mogure	Duci
16	Shufi Suli	Banulle	Suli
17	Saranda Krasniqi	Lipjan	Krasniqi
18	Valmir Abdullahu	Prishtine	Abdullahu
19	Megjori Megjorali	Shala	Megjori
20	Jatir Moxholli	SHALE	Moxholli
21	Burim Rexhepi	Banulle	Rexhepi
22	Djellza Hukolani	Dobriq e Madhe	Hukolani
23	Leonita Bubuka	Dobriq e Madhe	Bubuka
24	Ymeri Gjokani	POTUROC	Gjokani
25	Volter Gashi	TOG	Gashi
26	Ganimete Gashi	Lipjan	Gashi
27	Shenita Bytyqi	Lipjan	Bytyqi
28	Fatmir Shalaku	Lipjan	Shalaku
29	HYRA BYTYCI	LIPJAN	Bytyci
30	MILAIM MEHMETI	KONJUH	Mehmeti
31	MEFAJ BAJRAKTARI	BAIC	Bajraktari
32	Merita Haxholli	LIPJAN	Haxholli
33	FADIL KIFTARI	LIPJAN	Kiftari
34	ARTAN LESHI	PRISHTINE	Leshi
35	Dendresa Jashanica	Lipjan	Jashanica
36	Bardhyl Ibrahim	ALLOCIQ	Ibrahim

38	ASTRIT BUJA	BUJAN	<i>[Signature]</i>
39	Salih Ibra	Toplyan	<i>[Signature]</i>
40	HAZIR SULAMNIKU	TOPNICA	<i>[Signature]</i>
41	XHELAL KRASHI	SMALLUSHE	<i>[Signature]</i>
42	MURAT GJERISCH	SLLOVI	<i>[Signature]</i>
43	NAIM JAHIRI	S LLOVI	<i>[Signature]</i>
44	HAMRI RUSTEMI	Pr. SKENDERBET	<i>[Signature]</i>
45	Aulona Jashari	Gadime e ulës YAHK	<i>[Signature]</i>
46	Lirim Budlica	Lipjan YAHK	<i>[Signature]</i>
47	Ricart Haxeni	SLLOVI YAHK	<i>[Signature]</i>
48	Art Krasniqi	Lipjan - YAHK	<i>[Signature]</i>
49	BEKIM KRASHI	YAHK	<i>[Signature]</i>
50	FEHMİ GASTANI	JANJEVE	<i>[Signature]</i>
51	Skender Bektari	JANJEVE	<i>[Signature]</i>
52	Lysref Kelmendi	Pipari ropel	<i>[Signature]</i>
53	<i>[Signature]</i>	LELETIQ	<i>[Signature]</i>
54	Murtex Sylejmani	Kroze	<i>[Signature]</i>
55	HAKDI BRATO	SHALE	<i>[Signature]</i>
56	Qorim Faelik	YIZENI	<i>[Signature]</i>
57	HA Imoro	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
58	Xhyle Komori	SHALE	<i>[Signature]</i>
59	Bekhet Kongoli	JANJEVI	<i>[Signature]</i>
60	Arben Bytyai	Lipjan	<i>[Signature]</i>
61	TOM BUSAKI	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
62	HASAN UKA	DOBRAJE MADU	<i>[Signature]</i>
63	Muhammed Bektari	Lipjan	<i>[Signature]</i>
64	IMRI BITIGI	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
65	Mehdi Bektari	Smallush	<i>[Signature]</i>
66	HAZBI REGICA	LLUGIA XITI	<i>[Signature]</i>
67	BANYSK FARK	DRISHTI	<i>[Signature]</i>
68	Isref Hoxha	Lipjan	<i>[Signature]</i>
69	Bestar Krasniqi	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
70	BAJRUSI LIMANI	GADIME	<i>[Signature]</i>
71	Janda Shahini	MURIE	<i>[Signature]</i>
72	Bukmir Gjilja	Lipjan	<i>[Signature]</i>
73	Ganimeti Dera	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
74	Xhyside Rustemi	Romelli	<i>[Signature]</i>
75	Xhelal Thanasniqi	TEBE	<i>[Signature]</i>
76	Kasim HASANI	KASHI	<i>[Signature]</i>
77	Gjergj Regica	LIPJAN	<i>[Signature]</i>
78	ILIAM SYLEJMANI	MAGURE	<i>[Signature]</i>
79	FLAMUR SYLEJMANI	LELETIQ	<i>[Signature]</i>
80	Imri Semetishi	DRUM -	<i>[Signature]</i>
81	Scad Aliu	KK Lipjan	<i>[Signature]</i>
82	Safete Amenllahu	KK Lipjan	<i>[Signature]</i>
	Elmurze Behluli	KK Lipjan	<i>[Signature]</i>